




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027

Maj 2024

Përmbajtja

Hyrje.....	2
Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027.....	4
Dëgjimet publike buxhetore	Error! Bookmark not defined.

Hyrje

Bazuar në ligjin për Qeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017 si dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë (MAPL) Nr. 04/2023 të Hapur në Komuna, komuna e Rahovecit ka organizuar dëgjimet buxhetore.

Kalendari i dëgjimeve publike: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/05/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-publike-me-qytetare-per-KAB-in-2025-2027.pdf>

Grupi punues ka mbledhur komentet dhe në takimet e mbajtura me 30.5.2025 ka diskutuar kërkesat e qytetarëve dhe ka vendosur për pranimin refuzimin a po adresimin e tyre.

Sipas standardeve të UA nr 04/2023 grupi punues me shumicë votash ka vendosur sipas arsyetimeve që janë në këtë raport. Mbi kriteret e paracaktuara grupi punues ka vendosur të pranoj, refuzoj apo adresoj kërkesat që janë pranuar nga qytetarët gjatë dëgjimeve buxhetore. Sipas kriterëve të paracaktuara kërkesat janë trajtuar si vijon

Pranuar: Kërkesa të cilat grupi punues i ka vlerësuar nevojë për qytetarët dhe ka rekomanduar të futen në buxhetin e komunës

Pranuar pjesërisht: Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se ka nevojë dhe mund të përmbushen pjesërisht nga buxheti i komunës

Refuzuar: Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk mund të përmbushen nga buxheti i komunës dhe janë jashtë mandatit

Adresuar: Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk mund të adresohet nëpërmjet buxhetit për shkak se kërkesat adresohet nga institucionet e tjera apo mekanizmat administrativ të komunës dhe institucioneve të tjera

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike, si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo të refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Të dhëna të shkurtër për dëgjime buxhetore:

Nr	Emri dhe vendi i mbajtjes së dëgjimit	Data e mbajtjes	Nr. pjesëmarrëseve		
1	Dëgjim Publik në Sallën e Kuvendit <i>Me rininë, gratë, pensionistët dhe komunitetet pakicë</i>	21.5.2024 E martë	F 37	M 31	T 68
2	Dëgjim Publik në Sallën e Kuvendit <i>Me organizatat joqeveritare, bizneset, fermerë dhe grupet e interesit që veprojnë në komunën e Rahovecit</i>	22.5.2024 E mërkurë	F 23	M 15	T 38
3	Dëgjimi Publik në Sallën e Kuvendit <i>Me drejtorë të shkollave, koordinatorë të cilësisë, psikologët dhe pedagogët</i>	23.5.2024 E enjte	F 10	M 32	T 42
4	Dëgjim Publik në QKMF "Fahredin Hoti" <i>Me punëtorët shëndetësorë</i>	24.5.2024 E premte	F 23	M 19	T 42
5	Dëgjim Publik në Sallën e Kuvendit <i>Me kryetarë të fshatrave dhe lagjeve urbane</i>	27.5.2024 E hënë	F 0	M 20	T 20
			Femra----: 93 Meshkuj:-:117 Totali-----: 210		

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt - buxhetin e vitit 2025

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit ka prezantuar projekt - buxhetin për vitin 2025-2027. Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2024, në total prej 20.982.796.00 Euro, ku ky buxhet është ndarë në kategori, si:

1. Paga dhe Mëditje, në shumën prej 10.746.449.00 euro;
2. Mallra dhe Shërbime në shumën prej 2.761.006.00 euro;
3. Shpenzime komunale, në shumën prej 390.000.00 euro;
4. Subvencione dhe transfere në shumën prej 1.010.000.00 euro;
5. Investime Kapitale në shumën prej 6.075.341.00 euro.

Grupi punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027, në këtë përbërje:

- 1.1. Ekrem Bytyqi -kryesues;
- 1.2. Skender Hamza - anëtar;
- 1.3. Ardian Rama - anëtar;
- 1.4. Egzon Thaqi - anëtar;
- 1.5. Izet Morina - anëtar;
- 1.6. Muharrem Morina - anëtar;
- 1.7. Blerta Gashi - anëtar;
- 1.8. Albion Krasniqi - anëtar;
- 1.9. Qendresa Kryeziu - anëtare;
- 1.10. Mimoza Ejupi - anëtare;
- 1.11. Bahrije Çmega = anëtare;
- 1.12. Ardit Halilaj - anëtar;
- 1.13. Kosovare Gashi = anëtare;
- 1.14. Agnesa Ramadani - anëtare.

Grupi punues ka për detyrë që të hartojë **procesin e dëgjimeve buxhetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027**, të bëjë hartimin e Planit të brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktojë personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike dhe të bëjë hartimin e tij në afatin ligjor që parashihet në Udhëzimin Administrativ (Mapl) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna, të bëjë

hartimin e raportit nga dëgjimi buxhetor dhe ta përgatisë për ta dërguar në Kuvendin Komunal.

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi buxhetor me *Me rininë, gratë, pensionistët dhe komunitetet pakicë* që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 21.05.2024 në Parkun e Qytetit në Rahovec, me fillim në ora **10:30**.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: 18

- Femra ishin: 5
- Meshkuj ishin: 13

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 68

- Femra ishin: 37
- Meshkuj ishin: 31

Me rininë, gratë, pensionistët dhe komunitetet pakicë

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht Adresuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
Të nderuar të pranishëm përsëritet! I nderuar kryetar, i nderuar drejtor, të nderuar anëtar të grupit punues, të nderuar të pranishëm. Unë jam Defrim Kafexhiu anëtar i kuvendit Komunal dhe sot jam këtu edhe si anëtar i Kuvendit edhe si qytetar i thjeshtë i kësaj komune andaj desha të pyes pasi që buxheti për investime kapitale për vitin 2025 është 6,268,858.00 Euro, sa prej këtyre mjeteve kanë me shku për projekte të reja dhe sa prej tyre për projekte në vazhdim.	Defrim Kafexhiu:	Adresuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e kësaj kërkesë është në kompetencë të Komunës së Rahovecit dhe planifikimit buxhetor andaj Buxheti për vitin 2025 do të jetë 20,982,796.00 Euro, Paga dhe medijtje në vlerë prej 10,552,932.00 Euro, Mallra dhe Shërbime në vlerë prej 2,761,006.00 Euro, Shërbime Komunal në vlerë prej 390,000.00 Euro, Subvencione dhe Transfere në vlera prej 930,000.00 Euro si dhe Investimet Kapitale kapin vlerën prej 6,268,858.00 Euro prej të cilave në bazë kërkesave për projekte të reja përgjatë vitit do të ndahen dhe mjetet.	DBF
Mirëdita, unë jam Fahrije Thaqi nga fshati Xërxë, jam pensioniste dhe pensioni shumë i ulët nuk mjafton për mbulimin e	Fahrije Thaqi, Pensioniste:	Adresohet	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se nuk ka kompetenca për të vendosur për këto kategori, andaj ka vlerësuar se rritja e pensioneve është politike e nivelit qendror	DSHPS

shpenzimeve te medikamenteve mjekësore, andaj desha me ditë a ka naj shpresë që me na ndihmu pak.			dhe krejt çka mund të bëhet është t'i rekomandoj zonjës në fjalë për kërkesë për ndihmë momentale.	
Të nderuar përshëndetje, jam Gresa Kastrati dhe kërkesa ime është a do të punësohen psikologë dhe pedagogë në shkolla pasiqë mungesa e psikologëve në shkollën Selejdin Mullabazi në Rahovec paraqet shumë problem.	Gresa Kastrati, student:	Adresohet	Grupi punues ka vlerësuar se kërkesa nuk mund të adresohet nëpërmjet buxhetit. Do të adresohet si rekomandim në drejtorinë e Arsimit	DKA
Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne. Kërkesat janë: Rregullimi i nxemjes qendrore nëpër shkolla.	Enes Dula, student:	Adresohet	Grupi punues ka vlerësuar se kërkesa nuk mund të adresohet nëpërmjet buxhetit. Do të adresohet si rekomandim në drejtorinë e Arsimit	DKA
Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne. Kërkesat janë: Subvencionimi për artizanet. Ku çdo vit të ketë rritje si dhe subvencionimin e Bizneseve të grave për bizneset Start UP (bizneset fillestare).	Merisa Sharku, asambleiste:	Pranohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe i është drejtuar drejtorisë së Ekonomisë, të cilët pas një analize kanë konstatuar se në vitin paraprak janë subvencionuar bizneset start up, kështu që edhe për vitin 2025 parashihet subvencionimi edhe i bizneseve start up në vlerën monetare deri në 20 mijë euro	DEZHT
Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne. Kërkesat janë: A do të ketë rritje të numrit të bursave për vitin 2025.	Dren Uruqi, qytetar:	Pranohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe koordinim me drejtorinë e Arsimit ka konstatuar që do të ketë rritje të bursave.	DKA
Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne. Kërkesat janë: Kur do të përfundojnë punimet në qendrën rinore tek epopeja e UÇK-së	Shaip Shala, qytetar:	Refuzohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar se nuk ka të bëjë me dëgjime buxhetore	

Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne. Kërkesat janë:	Shefkije Alisallahu, qytetar:	Pranohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe koordinim me drejtorinë e Arsimit ka konstatuar që do të shikojnë mundësinë e furnizimit me video projektora.	
--	--------------------------------------	----------	--	--

2. Dëgjimi publik me qytetarët e komunës së Rahovecit, me fokus *Organizatat Joqeveritare, bizneset, fermeret dhe grupet e interesit,*

Dëgjimi buxhetor me *Organizatat Joqeveritare, bizneset, fermeret dhe grupet e interesit*, që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 22.05.2024 në Sallen e Kuvendit në Rahovec, me fillim në ora **10:30**.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: 19

- Femra ishin: 5
- Meshkuj ishin: 14

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin:38

- Femra ishin: 23
- Meshkuj ishin: 15

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
Përshëndetje i nderuar kryetar, pjesëmarrës tjer këtu të pranishëm. Unë deshta të bëj një pyetje se pse ka rënie të buxhetit në shendësi?	Mustaf Korenica, përfaqësues i bizneseve:	Pranohet	Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën dhe konstaton që nuk është vendim i nivelit lokal por i Ministrisë së Financave.	
Të nderuar të pranishëm, duke marr parasysh aktivitet e shumta të klubit KF Xërxë, është shumë e nevojshme fusha alternative për stërvitje. Andaj, po kërkojmë nga ju që të jetë prioritet në planifikimet buxhetore.	Ibrahim Kryeziu, fshati Xërxe:	Refuzohet		
Përshëndetje për të gjithë, po e paraqes një kërkesë rreth mungesës së stadiumit në fshatin Krushe e Madhe.	Fatmir Sejfullahu, Ansambli Bajram Curri Krushë e Madhe:	Refuzohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe konstaton që kjo nuk është përgjegjësi e nivelit lokal pasi niveli qendror e ka larguar Kodin pa asnjë arsyetim	

3. Dëgjimi publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus *drejtorët e shkollave, koordinatorët e cilësisë, psikologët dhe pedagogët*,

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi buxhetor me *drejtorët e shkollave, koordinatorët e cilësisë, psikologët dhe pedagogët*, që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 22.05.2024 në Sallen e Kuvendit në Rahovec, me fillim në ora **10:30**.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: 11

- Femra ishin: 4
- Meshkuj ishin: 7

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 42

- Femra ishin: 10
- Meshkuj ishin: 32

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
Përshëndetje i nderuar kryetar, pjesëmarrës tjer këtu të pranishëm. Unë kam një shqetësim, zvogëlimi i numrit të nxënësve a do të ketë ndikim në zvogëlimin e buxhetit për shkollën tonë.	Hasan Krasniqi, <i>drejtor i shkollës 12 Maji në Ratkoc:</i>	Pranuar pjesërisht	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë. Po, natyrisht, ka zvogëlim sepse buxheti për mallra dhe shërbime bazohet nga numri i nxënësve.	DBPZHR
Përshëndetje për të gjithë, po i paraqes disa kërkesa rreth shkollës: -Inventari i shkollës është në gjendje të mjerueshme, po deformohet në vitin e parë të furnizimit. -Mungesë e roletave-perdeve në shkolla,	Ramadan Krasniqi, <i>Drejtor i shkollës në Hoçe të Vogël:</i>		Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe në koordinim me Drejtorinë për Arsim, kemi të planifikuar me Plan të Prokurimit kontratën për furnizim me inventarë. Në momentin që lidhet kontrata do ta bëjmë edhe furnizimin e nevojshëm në shkolla.	DSHP

-Mjete konkretizimi duhet të ndahen në mënyrë të barabart, -Mungesë e librave në bibliotekën e shkollës.			Sa i përket mjeteve konkretizimit, ju njoftojmë se është një projekt që po vazhdon, e jemi të vetëdijshëm për shkollën tuaj, pra, do të parashihet edhe për ju. Projekti i furnizimit të shkollave me libra në bibliotekat e shkollës është duke vazhduar dhe gjatë vitit do të bëhet furnizimi.	
I nderuar kryetar dhe ju te pranishëm pjesëmarrës, kam një pyetje se a ka buxhet për paralele të ndara?	Ilir Kryeziu- Drejtore i shkollave Zogisht-Retijë:		Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën dhe ju informojmë se nuk ka buxhet të veçantë, bazuar në ligjet e aplikueshme, buxheti ndahet për shkollën amë edhe për paralelen e ndarë, në bazë të numrit të nxënësve.	DSHP

4. Dëgjimi publik me qytetarët e komunës së Rahovecit, me fokus *kryetarë të fshatrave dhe lagjeve urbane*

Dëgjimi buxhetor me *kryetarë të fshatrave dhe lagjeve urbane*, që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 22.05.2024 në Sallen e Kuvendit në Rahovec, me fillim në ora **10:30**.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: 13

- Femra ishin: 3
- Meshkuj ishin: 10

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 20

- Femra ishin: 0
- Meshkuj ishin: 20

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht Refuzohet	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
Të nderuar të pranishëm përsëritet, une i kam dy kërkesa për fshatin Zoqisht: • Kërkesë e banorve që të vazhdohet rregullimi edhe i pjesëve tjera të rrugëve. • Vazhdimi dhe rregullimi i lumit aty ku ka ngelur.	Enver Kabashi, përfaqësues i fshatit Zoqisht	Refuzohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e Urbanizmit ka konstatuar që Komuna e Rahovecit nuk ka kontratë për rregullimin e shtratit të lumit në Zoqisht pasi që kontrata që veçse është aktive dhe një pjesë do të mbulohet me grantin e performancës.	DSHP

I nderuar kryetar, drejtor të drejtorive dhe tjer te pranishëm. Po I paraqes disa shqetësime që i kemi, rrugët fushore janë të mjerushme si dhe objektet shkollore të demuluar.	Mirsad Qehaja, <i>përfaqësues i fshatit Retijë</i>	Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e bujqësisë dhe planifikimet investive konstaton që do të trajtohet deri në fund të vitit me kontratën e rrugëve fushore: 623-24-3803-5-2-1/C598.	DBPZHR
I nderuar kryetar nëse ka mundësi buxhetore para lapidarit të shkollës të bëhet një park si dhe kemi probleme me ujrat e zeza kanalizime.	Murat Morina, <i>përfaqësues i fshatit Malësi e Vogël.</i>	Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike konstaton se Komuna e Rahovecit ka dy kontrata të kësaj natyre: për zgjerimin e rrjetit në lagje që nuk ka dhe furnizimin me gypa sipas kërkesave të qytetarëve. Kontrata me nr. 623-23-171-1-2-1.	DSHP
I nderuar kryetar, kam disa kërkesa për fshatin Sopniq: • Rregullimi i përroit, zgjerimi i tij diku 6 metra i ngusht, • Rrethrotullimi në fshatin Pataqan dhe Sopniq, • Rrugë fushore, • Kanalizim në dy lagje.	Mensur Gashi , <i>përfaqësues i fshatit Sopniq</i>	Pranohet pjesërisht	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike konstaton se Komuna e Rahovecit ka dy kontrata të kësaj natyre: për zgjerimin e rrjetit në lagje që nuk ka dhe furnizimin me gypa sipas kërkesave të qytetarëve. Kontrata me nr. 623-23-171-1-2-1 dhe në koordinim me drejtorinë e bujqësisë dhe planifikimet investive konstaton që do të trajtohet deri në fund të vitit me kontratën e rrugëve fushore: 623-24-3803-5-2-1/C598	DKA

Dëgjimi publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus *punëtorë shëndetësorë*

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi buxhetor me *punëtorë shëndetësorë*, që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 24.05.2024 në QKMF “Fahredin Hoti”, me fillim në ora **13:45**.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: 7

- Femra ishin: 3
- Meshkuj ishin: 4

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 42

- Femra ishin: 23
- Meshkuj ishin: 19

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
I nderuar kryetar, unë që një kohë kam mungesën e një karrige stamotologjike.	Drita Durguti, Stamotologe	Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale ka konstatuar se kjo kërkesë do të realizohet.	DSHPS
Të nderuar pjesëmarrës, i nderuar kryetar, drejtoreshë e shëndetësisë, unë kam një pyetje: A do të mbetet me kaq buxheti ose a do të ketë mundësi për plotësimin e 8 vendeve të lira?	Albunit Kryeziu-Drejtor i QKMF-së	Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e shëndetësisë do të shikojmë mundësinë e hapjes së vendeve të lira të punës në bazë të mundësive buxhetore që kemi	DBPZHR
Përhëndetje, kryetar objekti i AMF-së në Opterushë nuk është në gjendje të mirë, a do të bëhet renovimi?	Liridon Hoxha, Mjek	Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale ka konstatuar se kjo kërkesë do të realizohet.	DUMM
Kërkesë për karrige, një në fshatin Çifllak dhe dy për në qender, si dhe të bëhen dy ndrrime në fshatin Çifllak dhe fshatin Ratkoc, rritja e analizave në fshatin Ratkoc dhe në Krushë të Madhe. Gjithashtu, rritja e sasisë së karburantit për shkak të vizitave nëper shtëpi.	Aydullah Bajraktari, Shef i stamotologjisë	Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale ka konstatuar se kjo kërkesë do të realizohet.	DSHPS